REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 08/17
Datë/Datum. 30.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Safije Saramati – Ekspert shqyrtues i prokurimit Fëllënza Abazi –Ekapert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **08/17** e OE **"Koslabor"** - Suharekë.		
Datë:	30.01.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 10.01.2017 me Nr. **08/17** nga OE **"Koslabor"** - Suharekë, për shqyrtimin e lëndës "Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur", me numër të prokurimit701/16/284/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Qendra Klinike Universitare e Kosovës .

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –. Qendra Klinike Universitare e Kosovës
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – Koslabor -Suharekë.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		20.01.2017		**20.01.2017**		**30.01.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 10.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 08/17 e parashtruar nga OE " **Koslabor"**, me seli në Suahrekë, gjatë fazës së tenderimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me reagensa për analizatorin Cobas E411 me sistem të mbyllur "**, me nr. të Prokurimit: 701/16/284/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Koslabor", me seli nëSuharekë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Koslabor"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- **Neni 6 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligji Nr.05/L-068 dhe Ligji Nr.05/L-092**
- **Neni 7 paragrafet 1,2 dhe 6 i Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-092**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me datë 27.12.2016 i jemi drejtuar AK me Kerkesen per Informacione shtesë si vijon :

Duke qene se Pajisja per te cilen kerkohen reagensat eshte Sistem i mbyllur (siq e thote edhe njoftimi ne kontrate) tek : kerkesat mbi mundsit teknike dhe /ose profesionale neni 9.1 & 9.2 ne FDT – Evidenca 4-Autorizimi i prodhuesit apo dilerit te autorizuar.Konoiderojme qe nje kerkese e tille eshte e pa arsyeshme ,diskriminuese dhe madje edhe e demshme (ne aspektin financiar) per vet AK .Duke e ditur se Kosova si treg eshte i vogel dhe prodhuesit kane vetem nga nje perfaqesues te tyre ketu si dhe qe reagensat per pajisjen e tille i prodhon vetem nje prodhues (Roche Diagnostics) atehere me kete kriter mundesin per te konkuruar e ka vetem nje OE.Ne kerkojme qe ky kriter te hiqet apo nese AK e sheh si te domosdoshme te njejtin atehere te zhvilloj kete AP me procedur te negocuar.

Konsiderojme qe Kriteri i tille eshte ne kundershtim me Nenin 7 pika 1,2 dhe 6 te Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042

AK ka kthyer pergjigjen me 29.12.2016 (nga njesia kerkuese –Klinika e Biokimise Mjeksore)e cila nuk pranon ndryshimin e ktitereve ?!

Te paknaqur me pergjegjen me date 04.01.2017 i jemi drejtuar AK me Kerkese per Rishqyrtim duke kontestuar kerkesat e Kolegjiumit te Biokimise Mjeksore si vijon:

Ne pergjigjen e tyre ata kerkojn qe:

- *Materiali i kerkuar t'i plotesoj te gjitha kriteret e cilesise dhe standardeve te vena nga prodhuesi:*
- *Nuk e kemi te qarte cila nenkupton kjo kur dihet se pajisja eshte sistem i mbyllur e qe*

S.S.

reagensat per te i prodhon vetem Roche Diagnostics ,per te njejtat kerkohet Autorizimi per Import nga AKPM .Per te marrur ate autorizim ne AKPM kerkohen CE ose Deklarata e konformitetit nga prodhuesi qe verteton cilesine.

- **Te transportohet dhe te ruhet ne kushte optimale*
- *Secili OE per te fituar Licencen e Veprimtarise si Qarkullues me shumice per Produkte dhe Pajisje Medicinale nga AKPM duhet te plotesoj kriteret e percaktuara me ligj ku bejne pjese ruajtja dhe transporit ne kushte optimale dhe te tjera .AK ka vepruar drejte kur ka kerkuar qe OE qe pretendojne te jene pjesmarres ne kete AP te jene te pajisur me kete licence .*
- *Mirepo keto dy kerkesa te Njesise kerkuese nuk jane ndonje sqarim ne kerkesen tone sepse ato jane te rregulluara dhe jane kompetence e institucionit qe eshte AKPM qe eshte pergjegjese per dhenie te licences si dhe monitorimin e punes te bartesve te licences.*
- **Te mundesohet aplikim profesional nga aplikuesit e licencuar nga prodhuesi si dhe*
- ** Te behet kalibrimi i testeve nga personeli i autorizuar*
- *Na intereson te dime kur eshte pranuar Pajisja per te cilen kerkohen reagensat ne Klinike*
- *Eshte organizuar apo jo nga OE qe ka derguar pajisjen trajnim i stafit per pune me*
- *Pajisjen qe gjithmone eshte rregull,por edhe obligim per OE qe shesin apo dhurojne pajisjet sidomos per ato mqe jane per here te pare ne ate institucion .Nese eshte organizuar trajnimi atehere personeli i Klinikes duhet te kryej vet veprimet qe kerkohen nga personi i autorizuar dhe nje gje e tille nga OE pastaje munde te kerkohet miqesisht ne ndonje rast por kjo nuk mund te vendoset si kriter per perzgjedhje me rastin e vleresimit te ofertave per furnizim me reagensa .*
- ** Te na mundesohet reklamimi i cdo problemi me testet . kalibrimet e kontrollat gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates*
- *Kjo kerkese na habit. Kush mund ti ndaloj dikujt reklamim te bazuar me argumentet te ndonje produkti .Kjo nuk eshte dicka me te cilen duhet te merremi .*
- *Ne konsiderojme qe pergjigja nga AK perkatesisht Kolegjiumit te njesise kerkuese nuk eshte pergjigje konform rregullatives ligjore ne Republiken e Kosoves dhe si rezultat i kesaj kerkojm nga AK te beje rishqyrtimin e Kerkeses sone te paraqitur me heret .*
- *Me date 05.01.2017 nga AK kemi pranuar Vendimin mbi Refuzimin e pretendimeve te kerkeses per rishqyrtim me arsyetimin:*
- *Zyra e prokurimit te QKUK-s,ka kerkuar nga Njesia e Kerkeses ,qe te pergjigjet ne kerkesat per informata shtese ku te njejtin me ane te shkreses me mr prot :483 (te bashkangjitur) nga kolegjiumi profesional i Klinikes se Biokimise Mjekesore ,kekrojne qe te mos ndryshohen kriteret.*
- *Bashkangjitur do te gjeni kerkesen per Informacione shtese dhe Kerkesen per Rishqyrtim si dhe pergjigjet nga AK.*
- *Ne si OE kundershtojme pergjigjen nga AK ne Kerkesen per Informacione Shtese si dhe Vendimin mbi Refuzimin e pretendimeve te Kerkeses per Rishqyrtim dhe kerkojme nga OSHP te shqyrtoj pretendimet tona dhe te sjell vendim lidhur me ankesen tone :*
- *Ne DT tek : kerkesat mbi mundesite teknike dhe /ose profesionale neni 9.1&9.2 ne FDT – Evidenca 4-kerkohet: Autorizimi nga prodhuesit apo dileri i autorizuar.*
- *Duke qene se Pajisja per te cilen kerkohen reagensat eshte Sistem i mbyllur (siq e thote edhe titulli i AP) dhe duke ditur se Kosova si treg eshte i vogel dhe prodhuesit kane vetem nga nje perfaqesues te tyre ketu si dhe qe reagensat per pajisjen e tille i prodhon vetem nje prodhues (Roche Diagnostics) atehere me kete kriter mundesine per te konkuruar e ka vetem nje*

5-8

OE.(Secili diler eshte i autorizuar per nje teritor te caktuar dhe nuk ka te drejte te jap autorizim nje kompanie e cila bene pjese ne teritorin qe kontrollohet nga nje diler tjeter i autorizuar nga prodhuesi – pra ne Kosove ka vetem nje diler te autorizuar nga prodhuesi dhe mundesia per te marrur autorizim nga nje diler i autorizuar siq parashihet ne DT nuk eshte reale).Ne kete rast ky kriter mund te krijoj mundesin e monopolit.

- *Konsiderojme qe ky kriter ne kete AP eshte ne kundershtim me :*
- **Neni 6 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligji Nr.05/L-068 dhe Ligji Nr.05/L-092**
- **Neni 7 paragrafet 1,2 dhe 6 i Ligjit Nr.04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-092**
- *Dhe kerkojme qe ky kriter te hiqet apo nese AK e sheh si te domosdoshem te njejtin atehere te zhvilloj kete AP me procedure te negocuar.*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	19.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	18.01.2017 , 13:00h
Data e hapjes së ofertave	18.01.2017 , 13:00h
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*
Lloji i kontratës:	*Kontratë kornize – 12 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE **III.2)Operatori ekonomik duhet ti Permbushe kerkesat e specifikuara ne nenin 65 te** **Ligjit te Prokurimit Publik (LPP)**	**Deshmia e kerkuar dokumentare :** **1.Nje deklarate e shkruar nen betim , e nenshkruar nga tenderuesi duke perdorur formen ne Aneksin2.** **Dokumentet te cilat do te kerkohen si deshmi per permbushje te kerkesave te pranueshmerise jane si vijon:** **a.Per situaten referuar pikes 6.2 [a,b,c,e,f] dhe pikes 6.3 [a,b dhe d], vertetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative te vendit te themelimit te tenderuesit .(origjinali ose kopja e noterizuar) .Per situaten referuar pikes 6.3 [h(tatimit)],vertetim i leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik ,se operatori ekonomik ne**

S.S

	fjale nuk eshte delikuent (shkeles) ne pagesen e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit[para dates se publikimit te Njoftimit te Kontrates].Deshmite lidhur me kërkesat e pranueshmerise do te kerkohen nga tenderuesi te cilit QKUK ka nder mend qe t'ia jap kontratën .Keto dokumente duhet te dorëzohen nga tenderuesi para dhenies se kontratës .Afati kohor per dorzimin e dokumentacionit te permendur eshte pese 5 dite nga marrja e njoftimit te QKUK ,per synimin e dhënies se kontratës . **Dështimi per te paraqitur një nga keto dokumente brenda afatit kohor te permendur ,do te thote qe tenderuesi do te refuzohet ,do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertes dhe QKUK do te vazhdoje me tenderuesin e radhes ne rang –liste.**
III.2.2) Pershtatshmeria profesionale: **Kerkesa 1. Certifikata e regjistrimit te biznesit si operator ekonomik ne regjistrin profesional ,komercial dhe /ose te korporates ne vendin e juaj te themelimit .**	Deshmia e kerkuar dokumentare : Evidenca 1. Te deshmohet me Certifikate te regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit –Kopje .
Kerkesa 2. Certifikate e numrit fiskal.	Evidenca 2. Te deshmohet me Certifikate te numrit Fiskal-Kopje .
Kerkesa 3. Certifikate e TVSh-se.	Evidenca 3. Te dëshmohet me Certifikate te TVSh-se-Kopje.
Kerkesa 4. Licenca valide nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (valide).	Evidenca 4. Te deshmohet se OE eshte i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice produkteve farmaceutike (me validitet).Kopje .
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar : Nuk aplikohet	Deshmia e kerkuar dokumentare: Nuk aplikohet
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Kerkesa 1:Certifikata te prodhuesit dhe kualitetit**	Deshmia e kerkuar dokumentare: Deshmia 1: Certifikata ISO 9001 dhe 13485
Kerkesa 2: OE duhet te kete furnizime te ngjashme	Deshmia 2: Liste te furnizimeve te ngjashme per 3 vitet e fundit s'bashku me referenca perkatese.
Kerkesa 4: Autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi.Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi-dileri kerkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.	Evidenca 4: Autorizimi nga prodhuesi ose nga perfaqesuesi i autorizuar nga prodhuesi (me te dhena mbi porodhuesin :adresa ,nr. Tel,email,ëeb faqja etj, per mundesi te verifikimit).Ne rast te autorizimit nga perfaqesuesi –dileri kerkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit te letres standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kerkese per rishqyrtim , me ç'rast AK ka refuzuar ankesen si te pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se reagensat per pajisjen Analizatori Cobas E411 me sistem te mbyllur i prodhon vetëm një prodhues (Roche Diagnostics), ekspertja teknike duke u bazuar edhe në sqarimet e autoritetit kontraktues ku është thënë se për këtë pajisje prodhohen reagensa vetëm nga prodhuesi i lartpërmenduri dhe duke pasur parasysh kërkimet që janë bërë në internet në lidhje me prodhuesit e reagensëve, mendon se është i qëndrueshëm ky pretendim.

Ekspertja shqyrtues duke pasur parasysh sqarimet e lartpërmendura të dhëna nga ekspertja teknike mendon se kërkesa e autoritetit kontraktues që OE ofertues duhet të kenë autorizim nga prodhuesi apo distributori, mendon se është diskriminuese dhe kufizuese ashtu siç parashihet në nenin 7 të LPP-së, pasi që i mundësohet vetëm një prodhuesi të ofertoj në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo njëkohësisht është në kundërshtim edhe me nenin 6 të LPP-së ku parashihet që *"Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit"*.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Eksperti shqyrtues/teknik i propozojnë Panelit Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik të aprovohet si e bazuar, ndërsa rekomandojnë që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik siç parashihet me LPP, ose nëse autoriteti kontraktues e sheh të arsyeshme dhe nuk ka mundësi tjera atëherë të zhvilloj këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të negociuar konform dispozitave ligjore të prokurimit publik. Ku parashihet që i takon autoritetit kontraktues dhe është kompetencë ekskluzive të vlerësojë nëse duhet të iniciohet një aktivitet i prokurimit me procedurë të negociuar.

S. S